



VENDIM

Nr. 67 Datë 11.05.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIMIN E SHOQERISE
“GAMA ENERGY” SH.P.K., NE AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 2, 8 dhe 10 pika 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**GAMA ENERGY**” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

Neni 9, pika 1, Formati i aplikimit është plotësuar ne mënyrë korrekte

Neni 9, pika 2 Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4./10 gërma 'a' Është e pa plotësuar.

Neni 9, pika 4./10 gërma 'b' Është e pa plotësuar.

Neni 9, pika 4./10 gërma 'c' Nuk ka realizuar kontrata të mëparshme me objekt tregtimin e energjisë elektrike.

Per dokumentacionet e munguara, do te njoftohet subjekti qe ne baze te “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit te Plote/te Pjesshëm dhe Rinovimit te Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për liçensimin e shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k., ne aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI